



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



**RECONCILIATION
AND CONFLICT
TRANSFORMATION**



SKEMA E GRANTEVE

PRILL, 2022

implementing partners



Community Building Mitrovica

Që nga themelimi i saj në 2001 nga një grup aktivistësh për të drejtat e njeriut, Community Building Mitrovica (CBM) ka mbrojtur transformimin e konfliktit dhe ndërtimin e komunitetit duke mundësuar bashkëpunimin dhe dialogun ndërmjet qytetarëve përtej ndarjes etnike. E themeluar në një kohë kur qyteti i Mitrovicës përballej me ndarje fizike, CBM vendosi t'i bëj ballë këtyre sfidave duke i luftuar këto rrymime ndarëse dhe në vend të saj të krijojë hapësira për qytetarët me profesione të ndryshme që të ofroj një mjedis të sigurt dhe dalëngadalë të rindërtojnë lidhjet dhe besimin.

Aktiviteti i RCT-së

Vizioni i RCT-së është që Kosova të bëhet një shoqëri ku ka bashkëpunim proaktiv, bashkëjetesë paqësore të grupeve të ndryshme dhe zbatim të plotë të vlerave demokratike për të gjithë qytetarët. Aktiviteti po zbatohet në bashkëpunim me OJQ-të "New Social Initiative" (Iniciativa e re sociale) (NSI) dhe Nismën e të rinjve për të drejtat e njeriut në Kosovë (YIHR-KS). Aktiviteti adreson nevojat aktuale të pajtimit ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në Kosovë në nivel individual, komuniteti dhe institucional. Qëllimi përfundimtar i programit është të kontribuojë për një shoqëri ku ka bashkëpunim të ndërsjellë, ekzistencë paqësore të grupeve të ndryshme dhe vlera demokratike për të gjithë qytetarët.

Hapësira gjeografike e komunave të cilat mbulohen nga ky Aktivitet janë **Leposaviqi, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Skenderaj, Vushtrri, Zubin Potoku dhe Zveçani.**

1. SYNIMI I THIRRJES

Kjo skemë granti synon të ofrojë mbështetje për komunitetin si dhe për **idetë e zgjidhjes së problemeve** në temën e **pajtimit, transformimit të konflikteve dhe ndërtimit të paqes**. Skema e granteve do të zbatohet në regjionin e Mitrovicës për individët dhe organizatat që punojnë në komunitet duke adresuar nevojat që kanë të bëjnë me ndërtimin e besimit ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në Kosovë.

2. E drejta për të aplikuar

Dy lloje të aplikantëve do të kenë të drejtën e aplikimit në këtë thirrje:

- Aplikanti kryesor, *entiteti që aplikon me formën e aplikimit*
- dhe bashkë aplikuesi (sit).

2.1 Aplikantët me të drejtë aplikimi:

Organizatrat:

- I regjistruar ligjërisht në Kosovë për një periudhë minimale prej 12 muajsh para afatit të fundit për dorëzimin e propozimit
- Të vijnë nga regjioni i Mitrovicës: **Leposaviqi, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Skenderaj, Vushtrri, Zubin Potoku dhe Zveçani**

- Përgjegjës i drejtpërdrejtë për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit me bashkë-aplikantin(ët), duke mos vepruar si ndërmjetës.

Individët:

- Të jetë pjesë e Rrethit koheziv nga regjioni i Mitrovicës (grup joformal i qytetarëve dhe aktivistë të shoqërisë civile të cilët janë pjesë e Aktivitetit të RCT-së)
- Duhet të aplikojnë në bashkëpunim me organizatat e komunitetit dhe të promovojnë zbatimin ndëretnik, duke i integruar kontaktet mes komuniteteve dhe ato të ndërtimit të besimit në qëllime dhe aktivitete.

Keni parasysh se aplikantët:

- Nuk mund të aplikojnë në këtë thirrje me më shumë se një aplikim
- Nuk mund të jenë përfitues të më shumë se një granti në këtë thirrje
- Nuk mund të jetë bashkë-aplikant edhe në një aplikim tjetër në këtë thirrje.

Projekt propozimet që përfshijnë elemente si më poshtë **NUK** do të pranohen:

- Propozime që NUK kontribuojnë në asnjë mënyrë në arritjen e objektivit të kësaj thirrjeje
- Veprimet që kanë lidhje me partitë politike dhe/apo kampanja politike
- Verpime që ndërlidhen kryesisht me sponsorizimet individuale për pjesëmarrje në punëtori, seminare, konferenca apo kongrese.

3. APLIKIMI DHE DORËZIMI

Ju lutemi ndiqni me kujdes të gjitha udhëzimet e mëposhtme. Propozimet që nuk plotësojnë kërkesat nuk do të merren parasysh dhe si të tilla nuk do të kenë të drejtë aplikimi:

- Propozimet duhet të dorëzohen me formularët në dispozicion dhe të ofruara me këtë thirrje; përshkrimi dhe buxheti
- Të gjitha aplikimet duhet të jenë të shkruara në gjuhën angleze
- Të gjitha faqet duhet të shënohen sipas radhitjes
- Çfarëdo shtese/ankesi duhet të shënohet qartë dhe të vendoset si referencë në tekstin e aplikimit
- Të gjitha buxhetet janë në dollarë amerikanë.
- Regjistrimi i vlefshëm i organizatës, si një entitet legal në Kosovë, pranë Departamentit të regjistrimit dhe ndërlidhjes me OJQ-të pranë Ministrisë së Administratës Publike në Kosovë
- Identifikues unik i identitetit nga Dun dhe Bradstreet (numri DUNS)
- Një Memorandum Bashkëpunimi në mes të aplikantëve dhe bashkë aplikantëve duke treguar qartë aplikuesin udhëheqës dhe bashkë aplikuesin (sit).
- Certifikata e Administratës tatimore në obligimet e entitetit
- Deklarata tatimore zyrtare apo raport i auditimit, nëse është në posedim.

4. Forma e aplikimit

Përshkrimi nuk duhet t'i tejkaloj gjashtë (6) faqe përshkrim; Propozimi duhet të përmbajë informata të mjaftueshme për një lexues në mënyrë që të kuptoj qartë se çfarë dëshiron të arrij aplikuesi/sja.

4.1. Buxheti i propozuar

Justifikim I buxhetit: Aplikantët duhet të paraqesin buxhete që lidhen drejtpërdrejt dhe ekskluzivisht me zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të propozuara. Andaj, të gjitha çmimet/kostot duhet të jenë realiste dhe duhet të jenë në përputhje me çmimet e tregut për veprimet e propozuara dhe pagesat e stafit. Është e domosdoshme që buxheti të shpërndahet në mënyrë logjike dhe të miratohet nga dy ose më shumë palë që aplikojnë në këtë thirrje. Më poshtë mund të gjeni listën e shpenzimeve që përfshihen/pranohen dhe ato që nuk përfshihen/pranohen. Community Building Mitrovica (CBM) ka të drejtë të kërkojë modifikime/ndryshime buxhetore nëse lind nevoja

4.2 Shpenzimet e miratuara

Të gjitha kostot duhet të deklarohen qartë në formën fillestare të buxhetit dhe duhet të ndodhin gjatë fazës së zbatimit të aktiviteteve të projektit:

- Shpenzimet për anëtarët e stafit; duke përfshirë pagesat për ekspertë, dhe individët e përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e aktivitetit
- Kompensimi për udhëtim dhe ushqim për ata që janë të përfshirë në projekt dhe për qëllime të zbatimit të aktiviteteve siç parashikohet në aplikacion
- Shpenzimet për blerjen e furnizimeve të ndërlidhura me aktivitetet e propozuara
- Çmimet e tarifave bankare në lidhje me aktivitetet e listuara në aplikacion
- Shpenzimet që vijnë direkt nga kërkesat e Kontratës (shpërndarja e informacionit, vlerësimi specifik për Aktivitetin, kontabiliteti, auditimi, përkthimi)
- Shpenzimet operative të zyrës si qiraja, shërbimet komunale, telekomunikacioni, mirëmbajtja, shkrimi, produktet higjienike, riparimi i pajisjeve të zyrës dhe pastrimi.

Shpenzimet që nuk do të mbulohen:

- Borxhet dhe shërbimet e borxheve (interesat)
- Shpenzimet që ndodhin përpara fazës së zbatimit të këtij granti dhe/ose pas përfundimit të kohëzgjatjes së tij
- Provizionet për humbjet në të ardhmen ose detyrimet e mundshme
- Shpenzimet e deklaruara nga përfituesi(t) dhe të financuara nga grante të tjera
- Blerjet e tokës apo objekteve

5. VIZIBILITETI/DUKSHMËRIA

Aplikantët duhet të jenë të përgatitur të bëjnë publik faktin se financohen në kuadër të Aktivitetit të Pajtitimit dhe Transformimit të Konfliktit. Aplikantët duhet të jenë të përgatitur të pranojnë udhëzimet dhe rregulloret specifike të vizibilitetit/dukshmërisë së donatorëve.

6. APLIKIMI DHE PROCESI I PËRZGJEDHJES

Të gjitha aplikacionet do të analizohen me kriteret si vijojnë:

Rëndësia e propozimit për grant	Këto kriteret do të masin rëndësinë e propozimit të grantit dhe aktivitetet e propozuara. Ai gjithashtu do të analizojë nëse aktivitetet janë në përputhje me qëllimin e përgjithshëm të thirrjes.	30
Ekspertiza e aplikantit udhëheqës	Ky aspekt i aplikantëve do të masë ekspertizën dhe kapacitetet e aplikantit kryesor për të zbatuar aktivitetet e propozuara.	20
Përputhshmëria e partneriteteve	Ky aspekt bën matjen e përputhshmërisë së aplikantëve dhe bashkë-aplikantëve të tyre. Përputhshmëria do të matet për të vlerësuar përvojën në punën së bashku dhe punën në fusha të ngjashme.	30
Propozimet e buxhetit	Ky kriter mat logjikën e propozim-buxhetit, si dhe nëse përputhet me çmimet e tregut kosovar.	20
Totali:		100

7. RISHIKIMI DHE PËRZGJEDHJA

Një komision i rishikimit të granteve do të vlerësojë të gjitha aplikacionet që i plotësojnë kushtet. Ky Komitet do të përbëhet nga tre (3) individë dhe do të vlerësojë dhe përzgjedhë të gjitha aplikacionet që i plotësojnë kushtet. Komisioni do të përbëhet nga individë që nuk janë në asnjë mënyrë të lidhur me zbatimin e përgjithshëm të Aktivitetit të Pajtitimit dhe Transformimit të Konfliktëve.

8. PUNËTORITË

CBM do të organizojë një punëtori për të gjithë individët/organizatat joqeveritare të interesuara nga regjioni i Mitrovicës që dëshirojnë të aplikojnë për grantebazuar në këtë thirrje për propozime. Punëtorja do të shërbejë si një udhëzues për aplikantët e mundshëm, d.m.th., do t'u sigurojë atyre të gjitha detajet dhe kërkesat e nevojshme për t'u kualifikuar për të aplikuar në këtë thirrje për propozime. Për më shumë informacione rreth punëtorisë ju lutemi vizitoni faqen e CBM-së në Facebook ose na kontaktoni përmes emailit në: info@cbmitrovica.org.

9. KOHËZGJATJA

07 prill, 2022 – Hapet thirrja

14 prill, 2022 – Punëtorja

28 prill, 2022 – Dorëzimi i projekt propozimeve finale

28 prill, 2022 – Thirrja mbyllet

15 maj, 2022 – Njoftimi i aplikantëve fitues

Afërsisht, data e zbatimi të projektit duhet të fillojë në prill 2022 dhe të mos zgjasë më shumë se tetor i vitit 2022.

Të gjitha aplikacionet duhet të dorëzohen së bashku me projekt propozime në: procurement@cbmitrovica.org duke shkruar në subjekt/temë: grante të RCT-së më së largu deri me 28 prill në përfundim të orarit të punës. Aplikacionet që vijnë me vonesë nuk do të konsiderohen.

Pyetjet: Të gjitha pyetjet mund të drejtohen tek z. Kenan Beqiri përmes emailit në kenan.beqiri@cbmitrovica.org më së largu deri me 20 prill.